



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.60/30428/23
 Kaçanik, 27.11.2023

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja **IX (nëntë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 27 nëntor 2023 (E hënë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhamxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi-OJQ.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht pëershëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e IX (nëntë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2023, data 27 nëntor, me këtë :

R E N D P U N E

- 1.Aprovimi i Prosesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. OVL UÇK-së në komunën e Kaçanikut ;
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri.Në saje të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

A P R O V O J

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Prosesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbali ? Prosesverbal i mbledhjes se VIII (tetë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2023, u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e, Aprovoj

Prosesverbalin e mbledhjes se VIII (tetë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2023, të datës 27.10.2023 / Lënda : 01Nr. 60/03-27605/23.

2. OVL UÇK-së në komunën e Kaçanikut ;

z.Ekrem Livoreka : Ne kemi pasur me realizua një vizitë me OVL e UCK-së, por shkaku i agjendës së festave është anuluar .

znj. Arta Avdiu : Duke marrë parasysh qe shqetësim i madh në Kosovë është marrja e ushtarëve UÇK-së, nga Gjykata speciale, desha të pyes se sa është numri i të ftuarve nga kjo gjykatë në vendin tonë dhe sa e shohin si shqetësim ata këtë dukuri që po ndodh në kohët e fundit.

Sa i përket çështjes së invalidëve të luftës, cilat janë problemet që ata ballafaqohen duke e ditur qe në kohët e fundit kanë pasur nevojë për ndihmën e protezave - gjymtyrëve që kanë humbur gjatë luftës ku në fakt ka pasur mungesë të furnizimit me proteza në vendin tonë. Një ashtu në kohët e fundit janë paraqitur edhe pakënaqësitë lidhur me shumën aktuale të pensionit andaj ju lutem të më informoni se cilat veprime janë ndërmarrë në këtë drejtim?. Shqetësim tjetër ka qenë edhe pensioni i veteraneve të punësuar, pse kjo kategori (veteranët të cilët janë të punësuar), nuk kanë të drejt pensioni, çfarë keni berë lidhur me këtë shqetësim?

z.Arben Thaci : Një ndër shqetësimet qe unë e vërej është vlera e ushtrisë çlirimtare, rast konkret e kemi pagën e veteranëve pér të cilët është shumë me rëndësi të kenë një rehati dhe komoditet më të madh , andaj është shqetësuese fakti i një page që kanë në vlerë prej 170 euro, pagë shumë e vogël pér mbulimin e nevojave personale si dhe nevojave familjare që d.m.th. është shumë shqetësues, pavarësisht a është numri i saktë i invalidëve, ku shpesherë edhe në media u spekulua mirëpo unë mendoj që duhet zgjidhet ky problem.

Sa i përket imazhit të gjykatës në Hagë, ky është një shqetësim shumë i madh . Unë si pjesë e Komitetit kisha dhënë pér shembull krejt javën që dita e çlirimtimit me pas aktivitete , me kanë madhështore si dhe me realizua vizita të ndryshme . Unë e kam bërë një promovim si OJQ, shpjegimi në orët e mësimit pér Ushtrinë Çlirimtare, me qëllim që gjeneratat e reja me u informua rrëth vlerës dhe rëndësisë se ushtrisë çlirimtare sepse një pjesë tyre nuk e din edhe kanë harruar dhe orë mësimi kur janë datat historike. Unë kam pasur një lloj haikingu shtigjeve të UÇK-së, të cilin e kemi filluar prej sheshit Komandant Bardhi, Zefi, Agim Bajrami dhe Qamil Ilazi, që shkon një nisje me ç'rast ju kemi shpjeguar qe nga këtu kanë filluar lëvizjet, kem vazhduar pér në fshatin Bob deri tek Kulla e Hasanit edhe kanë pas edhe efektin lëvizjet qe kanë pasur ushtarët e UÇK-së rruga e tyre qe kanë bërë deri te Kulla e Hasanit. Pjesë e organizmit ka qenë edhe OVL e UÇK-së dhe me Ministrin e sporteve dhe federatën e sportit shkollor është bërë një organizim i tillë. Prijës në këtë aktivitet ka qenë z. Xhabir Zharku dhe z. Rrustem Dema, të cilët ju kanë treguar nxënëseve rrëth luftës se si është bërë organizimi i luftës dhe pér çka ka shërbyer kulla Hasanit, andaj pér mu ky organizim ka qenë një sensibilizim pér gjeneratat e reja .

z.Betim Shala : Ne si komitet qe jemi është dashur me e trajtua apo monitorua këtë proces me qëllim qe ta identifikojmë se çka ka bërë komuna pér këto kategorji, a kanë pas ndonjë përparësi punësimi ndonjëri nga familjaret dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës.

z.Ekrem Livoreka : Sa është bashkëpunimi i mirë me Qeverinë dhe Organizatës së Veteraneve të Luftës në përgjithësi, e në veçanti për Kaçanikun ku përmes rrjeteve sociale shpesh shohim shume raste kur shumë ish ushtarë të UÇK-së kanë bërë vetëvrasje për shkak të kushteve të rënda ekonomike, pastaj shumë nga ish ushtarët janë në gjendje të rëndë sociale. Lidhur me gjendjen e invalidëve në komunën e Kaçanikut, a kanë përkrahje nga shteti për trajtim jashtë vendit, pasi qe është një kategori e shenjtë në këtë vend sepse kanë dhënë gjymtyrët e trupit për këtë vend prandaj duhet ta kenë edhe një trajtim të veçantë.

3.Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 13:37.

Procesmbajtësja
Mavije Murseli



**Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka**

